



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-12815/2018  
Kaçanik, 27.04.2018

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (Katërt)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 27 Prill 2018. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës –Ylber Bajra, drejtori i drejtive komunal( Zahir doda, Bahri Selimi, Ukshin Qallaku, Ramadush Osmani, Fatmir Loku, Festim Neziraj dhe Diana Reka), zyrtarët: Fatlume Selimi, Vedat Dema dhe Kaltrina Luma.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Profesor Dr. Sabri Kadriu, dhe një përfaqësuese nga Shoqata Gratë për Gratë-KOS.

Mbledhja u monitorua përmes Tel-prezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfîre Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi ekziston me u mbajtur mbledhja, kushte pune ka, andaj e hapi mbledhjen e IV (Katërt) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, data 27 Prill me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e III (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti Financiar për periudhën, Janar-Mars 2018;
3. Draft Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Kaçanikut;
4. Propozim Vendimi për dhënen në menaxhim të përkohshëm të tregut të gjelbër Ndërmarrjes Publike “ Stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik;

5. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;
6. Propozim Vendimi për dhënien e Pëlqimit, Organizatorit të Fondacionit "Idriz Seferi" për gdhendjen në shkëmb të figurës – heroit kombëtar, Idriz Seferi të Gryka e Kaçanikut; dhe
7. Plani i mbrojtjes nga zjarri për Komunën e Kaçanikut.

Materiali e mbledhjes e keni marrë, prezent në mbledhje është edhe Profesor Dr. Sabri Kadriu për pikën e 6. Nëse jeni të pajtimit pika e 6 për shkak që profesori mos të pres deri në fund të mbledhjes, këtë pikë e shqyrtojmë pas Procesverbalit. Me këtë ndryshim, Rendi i Propozuar i punës u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës aprovoj rendin e propozuar të punës prej 7 pikave, më ndryshim që pika e 6 të shqyrtohet pas pikës së dytë.

U kalua në shqyrtimin e pikave;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e III (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës;

Vërejtje në Procesverbal paraqitën:

**z. Bekim Koxha**, Në f.4, ku shënohet kafshët e egra, fjala “ egra” duhet të zëvendësohet me ‘fjalën’ imëta”.

**z. Ekrem Kyçyku**, Disa citimeve të anëtarëve të LVV i është ndërruar kuptimi, si diskutimit tim, diskutimit të Kaltrina Tafili si dhe diskutimit të Adnan Reka. Ne kërkojmë të bëhet incizimi direkt i mbledhjes, në mënyrë që të dëgjohet e tërë ajo që është diskutuar. Pasi që anëtarëve të LVV të cilët i potencova, na janë hequr pjesë të diskutimit, unë në emër të LVV konfirmoj se ne nuk do ta votojmë Procesverbalin e mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës.

**znj. Kaltrina Tafili**, Theksoj se në Procesverbal, diskutimit tim është hequr një pjesë gati kryesore të themi. Ne këtu kemi të drejtë të shprehim mendimet e tona, gjithashtu edhe të kritikojmë, pasi që kjo është detyra e jonë, ndërkaq kërkoj që Procesverbali të përmirësohet dhe të futet e gjithë fjala ime.

**z. Adnan Reka**, Kërkoj që mbledhjet e Kuvendit të Komunës të përcillen drejtpërdrejtë, ndërkaq shtoj na janë hequr disa citime në diskutime tona, me çka kujtoj se çështja e Procesverbalit po del çështje politike, ndërkaq kërkoj të di, përsë nuk është bërë incizimi i mbledhjes së III të rregullt të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nuk është e mundur të përfshihet çdo gjë në Procesverbal, sepse ka dikush që i ka 3 faqe diskutim dhe nëse i mbledhim diskutimin 10 anëtarëve të kuvendit, atëherë del procesi 30 faqe. Në faqen zyrtare të komunës nuk ka pasur mundësi të publikohet incizimi i mbledhjes, sepse faqja zyrtare ka pasur probleme për momentin. Nga Seanca e ardhme ka me qenë incizimi i mbledhjes drejtpërdrejtë. Vërejtjet duhet të epen konkret, siç ishte vërejtja e Bekim Koxha, ndërkaq diskutimi i krejt asaj që diskutohet nuk ka mundësi të shënohet në procesverbal, mirëpo incizimi ka me u bërë dhe kush çka ka diskutuar edhe qytetarët e komunës do të kenë mundësi me e dëgjuar. Me rëndësi është që

mos t'i humbet kuptimi diskutimit- mos të ndryshohen propozimet konkrete, vërejtjet dhe sugjerimet.

**z. Adnan Reka,** Nëse vazhdohet me u hequr pjesë të diskutimit kështu si është filluar, atëherë Procesverbali nuk del i plotë. Për këtë arsy, ne po kërkojmë të bëhet incizimi i dhe publikimi i mbledhjes live, kur dihet fakti se kjo nuk është vështirë të realizohet.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 5 anëtarët nga LVV. Abstenim nuk pati. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### APROVOJ

**Procesverbalin nga mbledhja e III e Rregullt e Kuvendit të Komunës të datës 30 Mars 2018/ Lënda : 01 Nr. 01Nr. 60/03-9465/2018.**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Konstatoj me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave. Nëse ka kush ndonjë pyetje apo kërkesë , lë të urdhëroj;

#### **Pyetjet dhe Kërkesat:**

**z. Ekrem Kyçyku,**

1. Shprehi shqetësimë te tija së për gjatë rregullimit të shtratit të lumit, Neredime, drunjtë e mbjellë për gjatë lumit, shumica e tyre janë tharë.
2. Në lagjen “ Mejdi Dalloshi”, janë krijuar vend deponi dhe usurpime të pronave. A mund të merret ndonjë hap në këtë drejtim nga ana e organeve komunale për me i evituar këto parregullsi.

**z. Selim Reka,** Me intereson të di, deri ku kanë arritur punimet projekti i Hallës e sporteve në Kaçanik. A është marrë ndonjë hap në këtë drejtim nga organet kompetente që ky projekt të realizohet.

**zpj. Nazife Krasniqi,** Kërkoj me u caktuar disa pika për hedhjen e mbeturinave të ngurta, e jo të hedhen këto mbeturina vend e pavend.

**zpj. Kaltrina Tafili,** Pas reshjeve atmosferike të ndodhura kohëve të fundit, është bllokuar rruga” Burim Rexha” në Kaçanik, me çka është krijuar vështirësi për qytetarët e komunës që jetojnë atë pjesë për lëvizje të lirë. Me intereson të di, a do të merren veprime të nevojshme nga organet kompetente për zhbllokimin e rrugës në fjalë.

**zpj. Vlora Dalloshi,** Pasi që shëndeti i qytetarëve është parësorë për komunën, me intereson të di lidhur me shërbimet shëndetësore sidomos nëpër fshatra, a plotësohen nevojat e qytetarëve për shërbime mjekësore. Ku kemi parasysh mungesën e mjekëve ose mosfunkcionimin fare të ambulancës mjekësore.

**z. Bekim Koxha,**

1. Paraqiti shqetësimet e tija për mbylljen e një rruge në f. Koxhaj për në f. Rekë nga kompania “Bektel Enka”, për të cilin problem janë mbledhur 100 nënshkrime të qytetarëve të komuniteteve. Më intereson të di ku ka ngelë kjo çështje.,
2. Të Projekti i kanalizimit të f. Koxhaj, banorët e kanë vërejtur se nuk është duke u mbikëqyrur mirë ky projekt nga ekzekutivi i komunës.
2. Është për lëvdatë larja e rrugëve të qytetit nga qytetarët me një aksion të cilin e kanë marrë vet ata.

**znj. Fatijona Kyçyku,** Pas një vizite që ia bëmë bibliotekës se qytetit pamë që është në gjendje te keqe. Me intereson të di se a keni ndonjë Plan komuna për përmirësimin e gjendjes së bibliotekës në fjalë.

**z. Shpend Krusha,** Pjetja është për drejtorin e DBPZH, Fatmir Loku; A janë njoftuar të gjithë bujqit e komunës së Kaçanikut për çështjen e subvencioneve në bujqësi. Si është çështja të kriteret për ndarjen e serave dhe të bletëve, sa është numri i përfitueseve dhe kush ka përfituar subvencione për këto projekte.

**znj. Hafize Sallahi,** Pjetja është për drejtorin e DUKMM, Ukshin Qallaku; Në mbledhjen e fundit z. Hajredin Luta adresoj një shqetësim, përmes administratorit të fshatit, për një projekt të realizuar në f. Ivajë. Opinionin e fshatit e mora, ata nuk janë të shqetësuar ku kanë shkuar mjetet, sepse projekt është realizuar në ujësjellës, ndërkaq kërkoi nga dikasteri përkatës t'na sigurohet një kopje e projektit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kërkesa të tjera nuk, përgjigjet do t'i merrni në mbledhjet vijuese nga shërbime përkatëse, ndërkaq konstatoj të procedojmë me pikën e 6 (gjashtë);

**6. Propozim Vendimi për dhënien e Pëlqimit, Organizatorit të Fondacionit” Idriz Seferi” për gdhendjen në shkëmb të figurës – heroit kombëtar, Idriz Seferi të Gryka e Kaçanikut;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materialin e keni marrë, kjo çështje është trajtuar edhe në mbledhje të KPF. Materiali ka do paqartësi për çështjen se në sa metra ka me u realizuar ky projekt, çështjen e konkursit etj. Për këtë pikë, fjalën ia jap fillimisht profesorit, Sabri Kadriu,

**z. Sabri Kadriu,** Fillimisht theksoj se ndihem i nderuar që jam në Kaçanik, në një vend historik të cilin e njeh bota. Në vazhdim dha sqarime të nevojshme lidhur Projektin sesi ka me u realizuar, çështja e financimit, dimensionet e projektit etj. Ideja është së, Fondacioni Idriz Seferi në një farë mënyre është aprovuar.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ne duhet të japim fillimisht Pëlqimin, për inicimin e procedurës sipas projektit të Fondacionit, Idriz Seferi si dhe fillimin e ndërtimin. Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku,** LVV e mirëpret këtë iniciativë, ndërkaq me intereson të di, a është shuma e mjaftueshme për realizimin e këtij projekti, ndërkaq në emër të LVV konfirmoj se e përkrahim inicimin e procedurës për realizimin e këtij projekti.

**z. Sabri Kadriu,** Theksoj se për mjete nuk ka problem, unë jam profesor i financave, donacionet do të jenë, Evropë, Azi etj.

**z. Ekrem Kyçyku,** Shuma e mjeteve të parapara si në Plan, është e vogël 39.000€. A mjaftojnë këto mjete për realizimin e këtij projekti.

**z. Sabri Kadriu,** Shuma e mjeteve si në Plan është shënuar gabim, sepse projekt kushton diku, 790.000€.

**z. Nexhat Loku,** Me intereson të di pse ky projekt nuk është nënshkruar nga anëtarët e këshillit organizativ.

**z. Shpend Krusha,** E përgëzoj Këshillin Organizativ për këtë iniciativë dhe çdo iniciativë tjetër i cili merret nga çdo iniciator për qëllim të mirë. Kaçaniku është vend historik dhe na bënë krenar ta kemi figurën e Idriz Seferit në Grykën e Kaçanikut. Unë e përkrahi këtë iniciativë, ndërkaq këtij projekti është mirë t'i bashkëngjitet edhe një Muzeum.

**z. Adnan Reka,** Si Kaçanik, shtrohet pyetja, a kemi bërë mjaft për figurën e Idriz Seferit. Ndërkaq po me vjen mirë që dikush është duke u marrë me këtë çështje, sepse historia e popullit shqiptar nuk ka filluar nga këtu. Me vjen mirë që ka ardhur koha, me i vlerësuar figurat e njohura të popullit shqiptar. Me intereson të di, a mund të realizohet në afatin prej 50 ditësh., ky projekt ashtu siç është përcaktuar në plan.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kërkoj të fokusohemi rrëth Propozim Vendimit, e mos të dalim jashtë rendit të punës.

**z. Selim Reka,** Ne subjekti politik i LDK e përshëndesim iniciativën e Fondacionit, Idriz Seferi, sepse me këtë shtatore do t'i kthehet nami figurës së, Idriz Seferit ashtu si e ka merituar dhe jo vetëm familja, por edhe ne do të ndihemi me krenar me realizimin e këtij projekti, por edhe çdo shqiptar që kalon për gjatë magjistrales; Kaçanik-Hani i Elezit dhe anasjelltas.

**z. Bekim Koxha,** Grupi parlamentar, Nisma e përkrahë këtë projekt dhe jemi të privilegjuar që jemi pjesë e këtij kuvendi me e mbështetë iniciimin e procedurës së këtij projekti. Ky projekt nderon identitetin e Idriz Seferit, nderon identitetin e komunës së Kaçanikut dhe të popullit shqiptar në përgjithësi.

**z. Besim Vishi,** Nuk po e kemi një foto me e pa se qysh ka me u dukur figura e Idriz Seferit e gdhendur në shkëmb, ndërkaq me intereson të di, a ka mundësi mos të jetë vetëm shtatorja, por t'i bashkëngjitet edhe do bashkëluftëtarë shtatores së Idriz Seferit.

**z. Ekrem Raka,** Ne jemi për me u zbatuar kushtet dhe kriteret e ndërtimit, sepse jemi dëshmitar se në shumë vende janë ngritur figura të shëmtuara. Projekti të jetë si akt moral estetikisht dhe artistikisht në nivel, në të kundërtën unë e tërheqë votën time.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kërkoj të mbështetët unanimisht kjo iniciativë, me kusht që pas Pëlgimit të bëhet studimi i fizibilitetit dhe veprime tjera të nevojshme sipas Ligjit për ndërtimin, pastaj edhe një herë kjo çështje të vjen në KK për aprovimin e projektit përfundimtar.

Diskutime të tjera nuk pati, kështu kjo çështje u shtrua në votim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë ,

### VENDIM

**Për dhënien e Pëlqimit, Organizatorit të Fondacionit” Idriz Seferi” për gdhendjen në shkëmb të figurës - heroit kombëtar, Idriz Seferi të Gryka e Kaçanikut.**

**Kryesuesi i kuvendit**, Konstatoj me kaluar në pikën e dytë të rendit të punës:

2. Raporti Financiar për periudhën, Janar-Mars 2018;

**Kryesuesi i Kuvendit, Për** këtë pikë fjalën ia jap drejtorit të DEFZH, Bahri Selimi, për sqarime të nevojshme.

**z. Bahri Selimi,** Shpjegoj për buxhetin e miratuar për vitin 2018 dhe atë të realizuar për gjatë tre mujorit të parë. Në vazhdim drejtori sqaroj edhe për të HVK në të gjithë sektorët aty ku ka pasur ngritje apo ulje në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Progres tha se ka pasur të inkasimi i Tatimit në Pronë, të Drejtoria e Urbanizmit, progres ka shënuar ka pasur të , Lejet e Ndërtimit, ndërkaq alokimi është më i ulët. Drejtori sqaroj edhe për mjetet e shpenzuara në të gjithë sektorët buxhetor, ndërkaq shtoj se ngritje të shpenzimeve ka pasur dhe të Mallrat dhe Shërbimet është të mirëmbajtja e rrugëve lokale. Të Investimet Kapitale, dihet se në këtë tre mujor sa herë shpenzimet janë me të vogla për shkak të kohës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** I dëgjuat sqarimet e drejtorit në Raportin financiar, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**Ekrem Kyçiku,** Edhe në mbledhjen e KPF i pata vërejtjet e mia të përqindja e mjeteve të shpenzuara e cila shumë është e vogël dhe nëse shpenzimet shkojnë me këtë ritëm, atëherë mund të ngelin mjete buxhetore në suficit. Në vazhdim z. Kyçiku evidentoj disa vërejte teknike të lëshuara për gjatë hartimit të raportit financiar.

**z. Ekrem Raka,** Të Tabela e përbledhjes së shpenzimeve të Mallrat dhe Shërbime,, pozicioni; Shpenzimet e varrimit janë, 12.521,57€. Nëse i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2017 shpenzimet në këtë pozicion, shihet se kanë shënuar rritje. Edhe pozicioni: Shpenzimet për mirëmbajtje të rrugëve lokale janë, 41.853.00€, e që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017, shihet se këto shpenzime shënojnë progres. Mendimi im është së, shpenzimet në këto dy pozicione janë shumë të mëdha për tre muajt e parë të vitit 2018.

**z. Selim Reka,** Në KPF i kemi dhënë vërejtjet tona. Realizim të madh shihet së ka të HVK të Tatimi në pronë, ndërkaq shqetësimi ynë është tek, Të hyrat nga inspektorati, janë 0 të hyra. Ky mos inkasim në këtë sektor është për mos punën e tyre. Të shpenzimet; Shpenzimet janë të ulëta të pozicioni: Investimet Kapitale dhe të pozicioni: Mallrat dhe Shërbimet. Kjo dukuri sa herë na përcjellë në tremujorin e parë të vitit buxhetor. Shpresoj që trendi i shpenzimeve të realizohet për gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018.

**z. Bahri Selimi,** Shpenzimet e varrimit eshtë paguar një pjesë për vitin e kaluar, sepse nuk kemi pasur mjete buxhetore. Shuma 7.500€ janë obligimet të mëhershme, ndërkaq vjetore janë 30.000€ vjetore.

Të mirëmbajtja, e rrugëve, DSHPE mund t'ua dërgoj me shkrim të dhënët në detaje për shpenzimet e krijuara. Dihet se këto shpenzime janë rritur për shkak të; vërvshimeve, reshjeve atmosferike etj.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Në ndryshimet e Statutit të Komunës, unë kam kërkuar nga komisioni që të hiqet fjala "miratimi i raportit finanziar", ndërkaq raportet tjera financiare në vazhdim të jenë në kuvend sa për "informim". Për këtë herë këtë çështje po e hedhim në votim ashtu si kemi vepruar deri me tanë. Rezultati i votimit, shumica janë Për, Kundër aprovimit janë anëtarët nga LDK, Abstenim 6 (anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka). Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë,

#### VENDIM

#### **Për aprovimin e Raportit Financiar për periudhën, Janar-Mars 2018.**

**3.** Draft Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Të qyteti i Kaçanikut, Këshillat Lokale në KPF eshtë vendosur të shtohet edhe një Këshill për Lagjen, Dushkajë.

**z. Ekrem Raka,** Të nenë 5 pika 2. të përfaqësimi gjinor, mos po paraqet problem kjo me u realizuar përqindja e përcaktuar sipas Ligjit për Barazi Gjinore. Të nenë 5 pika 10, të çështja e zgjedhjes së Kryetarëve të këshillave lokale për mënyrën e zgjedhjes së tyre eshtë mirë me ditur edhe rrëthin e dytë. Kjo pikë mendoj duhet të plotësohet sesi eshtë procedura në rrëthin e dytë për dy anëtarët e propozuar për Kryetar këshilli, .

**z. Selim Reka,** Për me funksionuar këto Këshilla, atëherë duhet të zgjidhet mënyra e kompensimit. Vullnet të mirë ma nuk ka, sepse ka përfunduar koha e vullnetarizmit. Unë mendoj se duhet të gjenden forma për kompensimin së paku të kryetarëve të këshillave.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Çështja e kompensimit ka të bëjë me çështje ligjore. Ne nuk mund të ndarë si pushtet të tretë Bashkësitë Lokale, kështu e kemi lënë një nen në Rregullore, në mënyrë që me shikuar mundësinë që në të ardhmen me u bërë diçka me ndonjë vendim të ndonjë organi (Kuvendit të Komunës apo Kryetarit). Të çështja e balancimit gjinor keni të drejtë, sepse Ligji për Zgjedhjet thotë 30%, ndërkaq Ligji për Barazi Gjinore, 50%. Ku eshtë shënuar në Rregullore 30% për balancim gjinor, hiqet e të shënohet që balancimi gjinor të në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore.

**z. Ekrem Kyçyku,** Unë edhe në KPF kam kërkuar me u ndarë lagja Dushkaja, me Këshill në veti, sepse edhe gjeografikisht ajo pjesë eshtë e ndarë.

**z. Bekim Koxha,** Të nenë 4 pika 1, kjo pikë të bënë me dije se subjektet e vogla politike nuk kanë të drejtë me qenë në komision.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Çështjen e komisioneve e përcakton ligji përfaqësimin e tyre. Nëse kanë mirëkuptim grupet parlamentare atëherë eshtë diçka tjetër.

**z. Bekim Koxha,** Mendoj se nuk paraqet problem për askënd që në komisione me pas përfaqësim më të madh të subjekteve politike.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Propozimet që dolën që Lagjja, "Dushkaja" me pasur një Këshill në veti në qytetin e Kaçanikut, dhe balancimi gjinor i përcaktuar në Draft Rregullore mos me u përmend, por të jetë sipas Ligjit për Barazi Gjinore. Me këto ndryshime këtë Draft Rregullore e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishte Bekim Koxha, Abstenim nuk pati. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori,

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Kaçanikut.**

**4.** Propozim Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të tregut të gjelbër Ndërmarrjes Publike " Stacioni i Autobusëve" Sh. A. Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për sqarime të nevojshme në këtë pikë, fjalën ia jap drejtorit të DUKMM, Ukshin Qallaku.

**z. Ukshin Qallaku,** Sqaroj se ky Propozim Vendim është bërë për një zgjidhje të përkohshme të Tregut të Gjelbër me ia dhënë në menaxhim Ndërmarrjes SH. A. Stacionit të Autobusëve, sepse nuk është duke pasur mundësi buxhetore me mbijetuar. Për të ardhmen nëse kush ka ndonjë ide për ndonjë lokacion tjeter, për me bërë zgjidhje me afatgjate, jemi për bisedime.

**Kryesuesi i Kuvendit,** I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka për këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku,** Në Arsyetim të Vendimit shënohet se , SH. A." Stacioni i Autobusëve" është në gjendje të rëndë. Është mirë ne si kuvend me pasur një, Raport për me ditur sa punëtor ka Stacioni i Autobusëve dhe çështjen e kompensimit, ndërkaq për përmirësimin e kushteve të stacionit, është mirë të formohet një komision për me shikuar gjendjen e kësaj ndërmarrje dhe veprimet e mëtutjeshme.

**z. Adnan Reka,** Parashtroj pyetje se a bëhet fjalë për parcelën të cilën e vizituam ne pas një seance të kuvendit. ndërkaq parashtroj pyetje përsë u tjetërsua ajo pronë, pasi që komuna nuk ka ndonjë lokacion tjeter të përcaktuar për zhvillimin e veprimitarisë së Tregut të Gjelbër.

**z. Ukshin Qallaku,** Kërkesa e pronarit ku ishte duke u zhvilluar Tregu i Gjelbër deri me tanë është që 1 vit me hequr tregun nga aty. Ne nuk kemi mundur me bërë zgjidhje për momentin, ndërkaq nëse ka kush ndonjë ide, ne jemi me ç' vendosur tregun nga aty.

**z. Besim Vishi,** Unë mendoj se duhet të shqyrtohet mundësia të, Parkingu i Invalidëve të luftës së UÇK. Në këtë drejtim me bërë marrëveshje me SHIL, ndërkaq atë pjesë afér Stacionit të Autobusëve që po mendohet me zhvilluar aktivitetin e vet tanë për tanë Tregu i Gjelbër, është mirë me e bërë Park.

**z. Ukshin Qallaku,** Pjesa ku ju po e propozoni për Treg të Gjelbër, aty është fituar tenderi për Hallë Sportive.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka-** Ne si LDK, jemi kundër asaj që me u dëmtuar Kalaja e Qytetit dhe ajo pronë e propozuar për tregun, sa e di unë është në kontest gjyqësor. Ndërkaq propozoj me u bërë diçka për të gjitha parkingjet për menaxhimin e tyre. Si lokacion i mundshëm ekziston një të Stacioni i Trenit, përballe Shtëpisë së Kulturës.

**z. Ekrem Kyçiku,** Një lokacion i mundshëm për Tregun e Gjelbër është anën së kundërt të lumit, të Fusha e Futbollit.

**z. Ekrem Raka,** Unë do të votoj kundër këtij Propozim Vendimi, sepse nuk është në rregull të vendoset Tregu i Gjelbër në një zonë të mbrojtur me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.

**z. Bekim Koxha,** Edhe unë do të jam kundër miratimit të këtij Propozim Vendimi në lokacionit e propozuar. Ai lokacion duhet të pastrohet, sepse ka mbeturina aty, ndërkaq ai lokacion është monument historik i mbrojtur me ligj dhe duhet të jetë në shërbim të qytetarëve .

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për momentin zgjidhja për Tregun e Gjelbër është për atë lokacion, sepse sot 1 javë është tregu dhe duhet t'iu bëjmë zgjidhje qytetarëve. Duhet me menduar në të ardhmen për një lokacion tjetër, ndërkaq tregu edhe me herët ka qenë në atë lokacion.

**z. Shpend Krusha,** Unë propozoj për këtë çështje të formohet një komision i kuvendit dhe ai komision në bashkëpunim me DUKMM dhe DSHPE të bëjë hulumtime të lokacionit për Treg të Gjelbër në mënyrë që të vjen deri të një zgjidhje. Një lokacion i mundshëm është të, Fabrika e Gëlqeres.

**z. Nexhat Loku,** Unë nuk e di përsë po bëhet problem lokacioni i propozuar, kur dihet fakti se do të jetë lokacion i përkohësish. Në emër të Grupit parlamentar të PDK, konfirmoju se e mbështetim lokacionin e propozuar si në Propozim Vendim të DUKMM.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kërkoj që për një çështje të caktuar të merret fjala vetëm një herë.

**z. Bekim Koxha,** Për një ndërrim destinimi që u aprovua më herët në një mbledhje të KPF të lokacioni ku u zhvillonte Tregu i Gjelbër, a ka pasur Kontratë ende komuna për atë lokacion për zhvillimin e veprimtarisë së tregut.

**z. Ukshin Qallaku,** Kontrata për lokacionin ku u zhvillonte Tregu i Gjelbër, është para 10 vjetëve. Të çështja e pastrimit të lokacionit të propozuar për treg, mirëmbajtjen e merr kompania, Sh. A “Stacioni i Autobusëve”.

**z. Adnan Reka,** Çështja e Parkingut dhe çështja e Tregut të Gjelbër, janë dy çështje që duhet të ndahen. Kështu si i tillë ky Propozim Vendim, përmendimin tim nuk kalon.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Tregu i Gjelbër sot është duke punuar pa Vendim në atë lokacion, ndërkaq çështja është se a do të bëhet zgjidhje për tregun për sot një javë. Për një zgjidhje të përhershme, unë propozoj që me shefat e grupeve parlamentare të dalim në teren për

hulumtime të lokacionit, ndërsa një zgjidhje të përkohshme duhet ta kemi për momentin. Meqë nuk ka diskutim tjetër, atëherë, Propozimin Vendimin për lokacionin e propozuar për Treg të Gjelbër e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për , Kundër ishin 12 anëtarë, Abstenim nuk pati. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për dhënien në menaxhim të përkohshëm të tregut të gjelbër Ndërmarrjes Publike “Stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik.**

**5. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ua sqaroj kuvendit se përbërja e këtij Komiteti do të jetë 5 anëtarë, 2 anëtarë do të jenë nga PDK, ndërkaq tre anëtarë nga tri subjektet politike me të mëdha, ashtu si e përcakton ligji. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin; Meqë nuk ka kush diçka atëherë kërkoj nga SHGP të shkojmë me propozime konkrete për anëtar të Komitetit për Shërbime Publike (KSHP).

**z. Nexhat Loku,** Nga subjekti politik i PDK, për anëtar të KSHP e propozojmë:

1. Hamid Guri dhe 2. Lirije Shurdhani.

**z. Ekrem Kyçiku,** Nga LVV për anëtar të KSHP e propozojmë, Adnan Reka,

**z. Selim Reka,** Nga LDK, për anëtar e propozojmë, Arlinda Rakoci-Raka.

**z. Shemsedibn Luzha,** Nga AAK e propozojmë, Afërdita Shehi.

Propozimet të cilat dolën u shtruan në votim për aprovim dhe të njëjtat u aprovua me votën Abstenim të Bekim Koxha. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike në përbërje:**

- |                        |                  |
|------------------------|------------------|
| 1. Hamid Guri,         | PDK, anëtar;     |
| 2. Lirije Shurdhani,   | PDK, anëtar;     |
| 3. Adnan Reka,         | LVV, anëtar;     |
| 4. Arlinda Rakoci-Raka | LDK, anëtar; dhe |
| 5. Afërdita Shehi,     | AAK anëtar.      |

**7. Plani i mbrojtjes nga Zjarri për Komunën e Kaçanikut;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për këtë pikë fjalën ia jap drejtorit të DSHPE, Ramadush Osmani.

**z. Ramadush Osmani,** Për hartimin e këtij plani është formuar grupi punues me Vendim të Kryetarit të Komunës. Në Plan janë përcaktuar objektivat dhe veprimet që duhet me i marrë në rast të rrezikut nga zjarri.

**Kryesuesi i Kuvendit,** I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçiku,** Plani është shumë i gjerë, me pas qenë me konkret ndoshta do të ishte me mirë dhe me i lehtë për ta përpunuuar. Në këtë Plan me kanë pëlqyer masat e parandalimit të zjarrit. Me intereson të di, a ka mundësi komuna e jonë me i ndjekur përvojat shteteve të tjera, që për grupet që dalin në intervenim, nëse iu ndodhë diçka me i marrë përgjegjësitë.

**z. Ekrem Raka,** Plani është dashur të jetë konkret e jo shumë voluminoz, ku 20 faqe të Planit janë vetëm profili i komunës, me çka kujtoj se janë shumë. Vërejtje tjetër është, numri i hidrantëve është shumë i vogël me vetëm 2 hidrantë. Mendimi im është që DSHPE duhet për vitin vijues të bëjë një Plan për shtimin e hidrantëve për shuarjen e zjarreve.

**z. Selim Reka,** Plani i mbrojtjes nga zjarri është e vërtetë se është shumë voluminoz. Të ndërtimet e reja të objekteve, sugjeroj DUKMM mos të jep leje ndërtimi pa pasur plani; hidrantët, shkallët alternative etj. Në çdo vendbanim të ngritet çështja e hidrantëve nëpër objekte të banimit dhe objekte të tjera. Ndërkaq një çështje të cilën e kam ngritur edhe me herët, është çështja e krijimit të një fondi emergjent.

**z. Shpend Krusha,** Ka qenë mirë me qenë prezent, Shefi i sektorit të emergjencave për me na shpjeguar për gjendjen e këtij sektori. Ky sektor dihet se është në gjendje të rëndë, ata kanë nevojë për pajisje dhe përkrahje financiare, si për; sallë për pushime, pajisje profesionale dhe pajisje të tjera të nevojshme.

**z. Nexhat Loku,** E përgëzoj shërbimin e emergjencave për këtë Plan të hartuar., ndërkaq konfirmoj vendimin se subjekti politik i PDK do ta përkrahim këtë Plan, ndërkaq është mirë që ky Plan t'i dërgohet edhe shkollave, në mënyrë që t'i mbahen nxënësve ligjérata për me pasur njojuri lidhur me pasojet nga zjarri kur ato shkaktohen.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë këtë Plan e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë,

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Planit të Mbrojtjes nga Zjarri për Komunën e Kaçanikut.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu Kryesuesi i Kuvendit në ora: 12:50 e konstatoj mbledhjen të përfunduar.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu  
*Malsiu*

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS  
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

**nga Mbledhja e IV (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2018, mbajtur me 27 Prill 2018.**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili .....
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,